



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Pridato Received/Delivary	22.07.2022	2 viti god year	
Organ/Njësia Organ/Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBSHCK	4263/2022		1/1



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr. 351/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi -Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 351/2019, të datës 21.06.2019, e ankuesit me adresë banimi

për mes përfaqësuesit juridik sipas Aktgjykimit A.Nr. 2323/2019, të datës 18.05.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të pranuar në KPMSHCK me datë 22.06.2022, kundër organit të punësimit Gjykata Themelore në Prizren në çështjen juridike "kompensimi material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.07.2022, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr.351/2019 e datës 21.06.2019, e parashtruar nga ankuesi.

II.SHFUQIZOHET Vendimin i datës 24.05.2019, me numër protokolli I.GJA.nr. 1/2019-74, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe Vendimi i datës 08.04.2019, me numër protokolli i Gja. Nr. 1/2019-63, i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës ka qenë i punësuar në Gjykatën Themelore në Prizren dega në Dragash, i cili është pensionuar me datë 16.05.2016, sipas Vendimit të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, ankuesi me datë 27.03.2019, me kërkesë për pagesën e tri pagave pas pensionimit i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke vepruar sipas Aktgjykimit të datës 18.05.2022, A. Nr.2323/19, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative ka bërë analizimin e shkresave të lëndës dha ka konstatuar se ankuesit me datë: 21.05.2026 i është përfunduar marrëdhënia e punës në kuadër të shërbimit civil të Gjykatës Themelore në Prizren dega në Dragash për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesi më datë 30.05.2016 kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Themelore në Prizren me pretendimet ankimore lidhur me pagesën e tri pagave në bazë të marrëveshjes Kolektive.

Komisioni për Zdhidhjen e Ankesave dhe Kontesteve kishte refuzuar ankesën e ankuesit ankuesi më datë 15.07.20216 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me të njëjtat pretendime lidhur me pagesën e tri pagave, ndërsa KPMSHCK me vendimin A/02/288/2016 kishte aprovuar ankesën e ankuesit pjesërisht duke i njohur vetëm një pagë pas arritjes së moshës së pensionimit duke u bazuar në ligjin e pagave për shërbyesit civil.

Këshilli në vendimin A/02/288/2016 kishte udhëzuar palën që në rast të pakënaqësisë mund të ndjekin rrugët ligjore dhe të hapni konflikt administrativ sipas padisë në Gjykatën kompetente, ndërsa Ligji për Konfliktin Administrativ Nr.03/L-202 përcakton në nenin 27 paragrafin 1 "Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës", prandaj nisur nga kjo rrethanë Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka dëshmi në shkresat e lëndës që të ketë hapur Konfliktin Administrativ ndaj vendimit të lartshënuar ashtu siç e parashe ligji në fuqi.

Kolegji ka anlizuar edhe kërkesën e ankuesit drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren me datë 27.03.2019 lidhur me kërkesën e tij për pagesën e tri pagave me rastin e arritjes së moshës së pensionimit, por ka konstatuar se kjo kërkesë është e bërë edhe me rastin e pensionimit dhe si e tillë është përmbyllur me Vendimin A/02/288/2016 të KPMSHCK ndaj të cilit vendim pala nuk ka hapur konflikt administrativ dhe ka humbur afatet lidhur me goditjen e këtij vendimi me mjete juridike.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr.351/2019

Rushit KAJFAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit; [REDACTED]
- Avokatit [REDACTED]
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren;
- Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën Themelore në Prizren;
- Arkivit të KPMSHCK-së

